



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Pml.nr.128/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Mejreme Memaj, kryetare e kolegjit, Rasim Rasimi dhe Agim Maliqi anëtarë, me bashkëpunëtorin profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të dënuarit Ç. L., për shkak të veprës penale tregtia e ndaluar në vazhdim nga neni 299 paragrafi 1 lidhur me nenin 77 të KPRK, duke vendosur sipas kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të dënuarit të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj-Departamenti i Përgjithshëm nr.2023:074319 të datës 16.06.2023 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti i Përgjithshëm PA1.nr.1129/2023, të datës 08.01.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 29.02.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të dënuarit Ç. L., e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj-Departamenti i Përgjithshëm nr.2023:074319 të datës 16.06.2023 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti i Përgjithshëm PA1.nr.1129/2023.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Ferizaj me aktgjykimin nr. 2023:074319 të datës 16.06.2023, të dënuarit R. S., M. P., D. D., G. D., i ka shpallur fajtor për veprën penale tregtia e ndaluar nga neni 229 paragrafi 1 të KPRK, për të cilën veprë të dënuarve R. S., M. P., D. D. dhe G. D. iu ka shqiptuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej nga 7 (shtatë) muajve i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse të dënuarit në afatin prej një viti pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit nuk kryejnë veprë tjetër penale dhe me dënim me gjobë në shumë prej nga 200 (dyqind) €, ndërsa të dënuarit S. P., D. S. dhe Ç. Ll., i ka shpallur fajtor për veprën penale tregtia e ndaluar në vazhdim nga neni 299 paragrafi 1 lidhur me nenin 77 të KPRK, të cilëve për këtë veprë iu ka shqiptuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej nga 10 (dhjetë) muaj i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse të dënuarit në afatin prej 2 (dy) viteve nuk kryejnë veprë tjetër penale dhe me dënim me gjobë në shumë prej nga 500 (pesëqind) €. Nëse të dënuarit nuk munden apo nuk dëshirojnë të paguajnë dënimin me gjobë, i njëjti do tu zëvendësohet me dënim me burgim ashtu që për çdo 20 € të

gjobës do të llogaritet me një ditë burgim. Të dënuarve në dënimin e shqiptuar iu llogaritet edhe koha e kaluar në ndalim nga data 08.04.2022 deri më 10.04.2022. Janë obliguar të dënuarit që secili veç e veç në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguajnë shumën prej nga 20 €, si dhe për kompensimin e viktimave të krimit secili veç e veç shumën prej nga 20 €.

Në bazë të nenit 92 paragrafi 1 të KPRK dhe nenit 269 dhe 270 të KPP, urdhërohet konfiskimi i parave që janë përfituar me kryerjen e veprës penale si në dizpozitivin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë.

Në procedurën ankimore Gjykata e Apelit e Kosovës – Departamenti i Përgjithshëm, me aktgjykimin PA1.nr.1129/2023 e datës 08.01.2023, e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e mbrojtësit të dënuarit, ndërsa aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë e ka vërtetuar.

Kundër aktgjykimeve të kundërshtuara, kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë ka paraqitur:

Mbrojtësi i të dënuarit Ç. L., avokati Kemajl Ademaj, për shkak të shkeljes së ligjit penal dhe shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, me propozim që kërkesa të aprovohet si e bazuar kurse aktgjykimet e kundërshtuara të ndryshohen ashtu që i dënuari të lirohet nga akuza në mungesë të provave.

Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit të Kosovës, me shkresën KMLP.II.nr.74/2024 e datës 28.02.2024, ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të dënuarit të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit pasi i shqyrtoi shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 435 paragrafi 1 lidhur me nenin 436 paragrafi 1 të KPPK-së dhe pasi i vlerësoi pretendimet nga kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë, konstatoi se:

- kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e pabazuar.

Mbrojtësi i të dënuarit në kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë, pretendon se aktgjykimet janë marrë me shkelje të ligjit material, sidomos dispozitat të cilat kanë të bëjnë me matjen dhe shqiptimin e dënimit. Më tutje në kërkesë pretendohet se aktgjykimi i shkallës së parë përmban shkelje të dispozitave të ligjit penal, lidhur me interpretimin dhe zbatimin e gabuar të nenit 92 të KPRK-së. Kjo pasi që dispozita ligjore nuk nënkupton që dobia pasurore të konfiskohet pa dhënë asnjë arsytim nëse vërtet mjetet e konfiskuara ishin përdorur për kryerjen e veprës penale, apo ishin rezultat burimor nga kryerja e veprës penale. Gjithashtu në aktgjykimet e instancave më të ulëta gjyqësore nuk janë paraqitur qartë dhe në mënyrë të plotë se në bazë të cilave fakte kanë ardhur deri te përfundimi se mjetet dhe sendet e konfiskuara ishin përdorur me qëllim të kryerjes së veprës penale ose buronin nga vepra penale.

Gjykata Supreme e Kosovës, konstaton se pretendimet e mbrojtësit të dënuarit janë të pabazuara, për faktin se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë dhe aktgjykimi i gjykatës së shkallës së

dytë nuk përmbajnë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale e as shkelje të ligjit penal, për arsye se dispozitivet e aktgjyqimeve janë të qarta, të kuptueshëm dhe konkret dhe përpilimi i tyre është bërë konform dispozitave ligjore.

Duke vlerësuar pretendimet e mbrojtësit të dënuarit, Gjykata Supreme e Kosovës e sheh të nevojshme fillimisht të theksoj faktin se i dënuari në shqyrtimin fillestar e ka bërë pranimin e fajësisë dhe si rezultat i konstatimit të gjykatës se janë përmbushur kriteret e përcaktuara, pranimi i fajësisë ishte aprovuar. Me këtë rast duhet theksuar fakti se pranimi i fajësisë në asnjë rrethanë nuk prejudikon caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, por e rëndësishme është që i dënuari ka qenë i njoftuar përkitazi me veprën penale, natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë, ndërsa i njëjti e ka pranuar fajësinë dhe atë në prezencë të mbrojtësit të tij.

Sa i përket pretendimeve ankimore të mbrojtësit të dënuarit lidhur me shkelje të ligjit penal, për faktin se gjykata e shkallës së parë kur ka vendosur që ti konfiskohen mjetet financiare-paratë si dhe mallrat të dënuarit nuk ka vepruar konform dispozitave ligjore dhe se nuk është dashur që të njëjtit ti konfiskohen, pretendimi është i pabazuar.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, konfiskimi i mjeteve financiare –parave është bërë në pajtim me dispozitën ligjore nga neni 269 paragrafi 1 dhe 270 të KPP, në të cilën dispozitë gjykata e shkallës së parë e ka bazuar vendimin për konfiskimin e mjeteve, të cilin e mbështet edhe kjo gjykatë. Sipas dispozitës së nenit 269 paragrafi 1 të KPP-së, parashihet se pas dënimit të të pandehurit për veprë penale, gjykata konfiskon të gjitha pasuritë e specifikuar të përcaktuara në aktakuzë ose në njoftim sipas nenit 278 paragrafi 5 të këtij Kodi, dhe sipas nenit 270 paragrafi 1 të KPP-së, ku është përcaktuar se para se gjykata të mund të urdhërojë konfiskimin e pasurisë që ishte mjet, Prokurori i Shtetit e provon në shqyrtim kryesor se pasuria ishte mjet i veprës penale për të cilën i pandehuri është dënuar, nga këto dispozita rezulton se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vepruar kur ka bërë konfiskimin e mjeteve financiare-parave sepse kjo është vërtetuar me provat e administruara nga gjykata dhe është në harmoni dhe në pajtim me dispozitat ligjore të lartcekura, andaj kjo gjykatë vlerëson se pretendimi është i pabazuar.

Nga arsyet e cekura më lartë, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë, është refuzuar si e pabazuar dhe në pajtim me dispozitën e nenit 437 të KPPK është vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË

Pml.nr.128/2024, më datë 29.02.2024

Procesmbajtës,
Bujar Balaj

Kryetarja e kolegjit,
Mejreme Memaj